



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
KOMISIONI I POSAÇËM PARLAMENTAR

VENDIM
Nr.3, datë 14.06.2024

“Për përfaqësimin e Institucioneve të Pavarura dhe Agjencive Ekzekutive Ligjzbatuese me përfaqësues/ekspertë pranë Grupit të Ekspertëve në Komisionin e Posaçëm Parlamentar”

Bazuar në nenin 24 të Regullores së Kuvendit dhe në pikën VIII paragrafi 1 të vendimit nr. 50/2024 të Kuvendit të Shqipërisë “Për krijimin e Komisionit të Posaçëm Parlamentar “Për thellimin e reformave për Mirëqeverisjen, Sundimin e Ligjit dhe Antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Evropian”, me propozim të kryetarit Komisioni i Posaçëm

VENDOSI:

1. T’u drejtohet Institucioneve të pavarura që krijohen nga Kuvendi (Lista 1 bashkëlidhur) që deri më datën 27.06.2024, të propozojnë emrat e përfaqësuesve/ekspertëve me të cilët do të përfaqësohen për të bashkëpunuar dhe kontribuar me ekspertizën e tyre me grupet e punës pranë Komisionit të Posaçëm Parlamentar.
2. T’u drejtohet Agjencive Ekzekutive ligjzbatuese (Lista 2 bashkëlidhur) që deri më datën 27.06.2024, të propozojnë emrat e përfaqësuesve/ekspertëve me të cilët do të përfaqësohen për të kontribuar dhe bashkëpunuar me ekspertizën e tyre me grupet e punës pranë Komisionit të Posaçëm Parlamentar.
3. Të autorizojë kryesinë e Komisionit për t’u komunikuar institucioneve të sipërpërmendura vendimin e Kuvendit, objektin e punës së komisionit, organizimin dhe kohën e veprimtarisë së tij si dhe kriteret e cilësitë e domosdoshme që duhet të përmbushin përfaqësuesit/ekspertët e tyre për t’u përfshirë në këtë proces.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

FATMIR XHAFAJ

Miratuar me 14.06.2024

Lista 1

1. Avokati I Popullit
2. Autoriteti I Mbikëqyrjes Financiare
3. Autoriteti i Konkurrencës
4. Inspektor I Përgjithshëm Inspektorati I Lartë i Deklarimit Dhe Kontrollit Të Pasurive Dhe Konfliktit Të Interesave (ILDKPI)
5. Instituti I Statistikave (INSTAT)
6. Kontrolli I Larte I Shtetit
7. Komisioneri Për Të Drejtën E Informimit Dhe Mbrojtjen E Të Dhënave Personale

LISTA 2

Agjensitë Ekzekutive Ligjzbatuese

1. Agjencia e Auditimit të Programeve të Asistencës, Akredituar nga Bashkimi European;
2. Agjencia e Inteligjencës Financiare (AIF);
3. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike
4. Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI)
5. Inspektorati Qendror/ Këshilli i Ministrave
6. Policia e Shtetit
7. Agjencia e Prokurimeve Publike